

Home > Aktualitet > Sherr në Zall Herr/ Të rinjtë shkojnë të ballafaqohen me komandon pas konfliktit...

AKTUALITET

Sherr në Zall Herr/ Të rinjtë shkojnë të ballafaqohen me komandon pas konfliktit në drekë, 34-vjeçari plagos dy prej tyre në sy të gruas, arrestohet

Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e sotme në Zall Herr, buzë një lokali në periferi të Tiranës. Beshiri tashmë është vënë në pranga, dhe është shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.5 në Kamëz. E gjithë ngjarja ka ndodhur në sy të bashkëshortes së komandos. Arma me të cilën u kryen plagosjet është sekuestruar.



Foto ilustruese

31 Gusht, 2020 22:23

TIRANË– Klodian Beshiri, komando në Zall Herr është vënë në pranga pasi akuzohet për një plagosje të dyfishtë. Mësohet se Beshiri, ka plagosur me armë zjarr 26-vjeçarin Rexhep Qefalia, ndërsa shokun e këtij të fundit, Redi Myrto, e ka lënë të plagosur, duke e goditu me qytën e pistoletës në qafë dhe në kokë.

Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e sotme në Zall Herr, buzë një lokali në periferi të Tiranës. Beshiri tashmë është vënë në pranga, dhe është shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.5 në Kamëz. E gjithë ngjarja ka ndodhur në sy të bashkëshortes së komandos. Arma me të cilën u kryen plagosjet është sekuestruar.

Ndërkohë, dy të plagosurit janë dërguar në spital, ku po merrin mjekimin e nevojshëm dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Por përse ndodhi sherri, si erdhën dy të plagosurit?

Shkaku dhe ‘molla’ e sherrit që solli dy të plagosur mbrëmjen e sotme në Zall Herr, ka qenë vëllai i një prej ‘viktimave’, Redi Myrto, Danieli. Mësohet se ky i fundit, është konfliktuar me komandon, që është edhe autori, Klodian Beshiri, pasdreke, ditën e sotme. Më pas, ai ka takuar të vëllanë dhe bashkë me tre persona të tjerë, mes tyre dhe Rexhep Qefalia, kanë shkuar të përballen me komandon Klodian Beshiri, në një lokal, buzë rruge në Zall Herr. Edhe pse Beshiri ishte nën shoqërinë e gruas, të rinjtë iu afruan që ta godisnin. Ky i fundit, nxorri armën, dhe qëlloi Qefalinë, ndërsa 23-vjeçarin Redi Myrto e goditi me qytën e armës.

(f.m/dosja.al)

22:44 - **U zunë pas dreke, Redi Myrto mblodhi ‘çunat’ dhe shkoi të përballej me komandon pasi iu zu me të vëllanë, 34-vjeçari nxorri armën në sy të gruas dhe i plagosi**

Shkaku dhe ‘molla’ e sherrit që solli dy të plagosur mbrëmjen e sotme në Zall Herr, ka qenë vëllai i një prej ‘viktimave’, Redi Myrto, Danieli. Mësohet se ky i fundit, është konfliktuar me komandon, që është edhe autori, Klodian Beshiri, pasdreke, ditën e sotme. Më pas, ai ka takuar të vëllanë dhe bashkë me tre persona të tjerë, mes tyre dhe Rexhep Qefalia, kanë shkuar të përballen me komandon Klodian Beshiri, në një lokal, buzë rruge në Zall Herr. Edhe pse Beshiri ishte nën shoqërinë e gruas, të rinjtë iu afruan që ta godisnin. Ky i fundit, nxorri armën, dhe qëlloi Qefalinë, ndërsa 23-vjeçarin Redi Myrto e goditi me qytën e armës. Më pas 34-vjeçari u vu në pranga. Ndërsa dy të plagosurit, ndodhen në spital, jashtë rrezikut për jetën.



22:32 - **LAJMI I FUNDIT/ Sherri me dy të plagosur në Zall Herr, arrestohet komandoja, sekuestrohet arma me të cilën qëllloi**

Tiranë. Ndërhyrja në kohë e Policisë parandalon përshkallezimin e konfliktit mes tre shtetasve. Vihet në pranga autori i dyshuar i plagosjes me armë të 26-vjeçarit dhe plagosjes me qytë të pistoletës të 23-vjeçarit. Para një ore në Zall-Herr, pranë nje lokali, në rrugë, shtetasi K.B., 34 vjeç, gjatë një konflikti për motive të dobëta ka plagosur me armë zjarri në kofshë, shtetasin R. Q., 26 vjeç dhe ka goditur me qytë pistolette në kokë shtetasin R. M., 23 vjeç, të cilët ndodhen në spital nën kujdesin e mjekëve pa probleme per jeten. Ndërhyrja e menjëhershme e Policisë bëri të mundur kapjen dhe shoqërimin e autorit të dyshuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.5 në Kamëz. Në cilësinë e provës materiale është sekuestrua arma e zjarrit me të cilën autori kryeu plagosjet. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë vijon punën për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.



ETIKETA: #DANIEL MYRTO #KLODIAN BESHIR #PLAGOSJE NE ZALL HERR #REDI MYRTO #REXHEP QEFALIJA

12
SHARES



Previous article

The Weekend tremb fansat, shfaqet i gjakosur dhe me shenja dhune në VMA, doli dhe në rrugë

Next article

Sherri me dy të plagosur në Zall Herr, arrestohet komandoja, sekuestrohet arma me të cilën qëllloi

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME

Aktualitet



Ishin nisur fshehurazi nga Durrësi, kapen dy sirianë në Bari dhe kthehen në Shqipëri,...

Aktualitet



Kuqezinjtë mbërrijnë në Minsk, Duka shfaqet në aeroport me të vëllanë, Kombëtaren e...

Aktualitet



Vjehri iu hodh nga Sanatoriumi, Gjetan Gjetani i prekur: Sot shfaqti probleme...

Aktualitet



TELEFONATA E FUNDIT/ Zbardhet komunikimi i pacientit që u hodh nga spitali 'Shefqet...

RATECH
PROFESSIONAL SECURITY SYSTEMS

codeit



STAY CONNECTED


f Facebook LIKE

t Twitter FOLLOW

i Instagram FOLLOW


y Youtube SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT



2 Shtator, 2020 23:16

Ishin nisur fshehurazi nga Durrësi, kapen dy sirianë në Bari dhe kthehen në Shqipëri, njëri prej tyre tentoi t'i marrë pistoletën një karabinieri



2 Shtator, 2020 23:10

Kuqezinjtë mbërrijnë në Minsk, Duka shfaqet në aeroport me të vëllanë, Kombëtaren e shoqëron edhe Alibeaj me Kokëdhimën




2 Shtator, 2020 22:36

Vjehri iu hodh nga Sanatoriumi, Gjetan Gjetani i prekur: Sot shfaqti probleme psikologjike, do flas në një moment të dytë



2 Shtator, 2020 22:31

Ruçi nga Vlora: Lufta Kombëtare e vulosi fitoren e parlamentarizmit që u themelua në Lushnje



2 Shtator, 2020 22:12

TELEFONATA E FUNDIT/ Zbardhet komunikimi i pacientit që u hodh nga spitali 'Shefqet Ndroqi' me fqinjin: Më duket se ja hodha...s'do isha shtruar kurrë po ta dija ç'bëhet



2 Shtator, 2020 22:00

Oksford vijon të jetë universiteti më i mirë në botë për të pestin vit radhazi, por Cambridge renditet i gjashti në rang global

Stafi

Drejtor : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :

Gazeta Muça
Florida Mingla
Riviera Gjyli
Dezdemon Kolaveri
Glenis Shabani

Anest Barjamemaj
Janula Vila
Alket Spata
Artjola Cani
Anila Kolgjini